



**GERMIN**  
**REPUBLIKA E SHQIPERISE MINISTRI I SHTETIT PËR DIASPORËN**

**MEMORANDUM MIREKUPTIMI**  
**MIDIS MINISTRIT TE SHTETIT PER DIASPOREN TE REPUBLIKES**  
**SE SHQIPERISE**  
**DHE**  
**ORGANIZATES GERMIN PER BASHKEPUNIMIN NE FUSHEN E DIASPORES**

Ministri i Shtetit të Republikës së Shqipërisë dhe GERMIN (organizatë joqeveritare, e regjistruar në Prishtinë, Republika e Kosovës, me fokus përfshirjen dhe angazhimin e Diasporës në zhvillim) më poshtë të referuara si “Palët”, me synim nxitjen e bashkëpunimit të tyre dypalëshe në fusha të ndryshme për angazhimin e diasporës;

Të bindur që bashkëpunimi në fushën e diasporës është një instrument me vlera për cilësinë e jetës të pjesëtarëve të diasporës që jetojnë jashtë vendit amë:  
Palët kanë rënë dakord si më poshtë:

**Neni 1**  
**Qëllimi dhe fushëveprimi**

1.1. Memorandumi i Mirëkuptimit përcakton kushtet për bashkëpunimin dhe përgjegjësitë ndërmjet Palëve.

1.2. Qëllimi i këtij Memorandumi të Mirëkuptimit është të krijojë një kornizë bashkëpunuese, të lehtësojë dhe të forcojë bashkëpunimin midis Palëve, në mënyrë jo-ekskluzive, në fushat me interes të përbashkët në funksion të forcimit të rolit të Diasporës Shqiptare për zhvillimin social dhe ekonomik.

**Neni 2**  
**Përgjegjësitë e palëve**

Palët bien dakord që:

1. Të mbajnë dhe të ruajnë bashkëpunimin i cili respekton pavarësinë profesionale dhe transparencën e veprimtarisë;
2. Të bashkëpunojnë dhe të koordinojnë për hartimin, zhvillimin dhe zbatimin e programeve të përbashkëta në fushat prioritare, të cilat do të jenë të përcaktuara në këtë Memorandum Mirëkuptimi, nëpërmjet shkëmbimit të informacionit mbi tema të caktuara në bazë të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Diasporën Shqiptare;
3. Të shkëmbejnë dokumente dhe informacione specifike në lidhje me programet e punës që janë me interes për secilën nga Palët;
4. Të takohen për të diskutuar çështjet me interes të përbashkët.



### **Neni 3**

#### **Fushat prioritare të angazhimit**

Palët bien dakord të forcojnë bashkëpunimin e tyre në fushat e mëposhtme specifike të lidhura me angazhimin e Diasporës:

1. Korniza ligjore dhe institucionale për përfshirjen e diasporës;
2. E drejta e votës për diasporën dhe përfaqësimi në Kuvend;
3. Politika Ekonomike dhe investimet për diasporën;
4. Promovimi i shkëmbimit profesional me diasporën shqiptare;
5. Shkëmbimi edukativ dhe kulturor;
6. Promovimi i projekteve të diasporës lokale në qytetet/rajonet e përzgjedhura në vendet respektive;
7. Organizatat jo-qeveritare dhe Filantropia e diasporës shqiptare;

### **Neni 4**

#### **Shërbime këshilluese**

1. Palët bien dakord që GERMIN të ketë rol këshillues në drejtim të Ministrit të Shtetit për Diasporën. Ky rol nënkupton edhe mbështetje me asistencë teknike, këshilla strategjike dhe lehtësim të dialogut me anëtarët e komunitetit shqiptarë që jetojnë jashtë vendit.
2. Palët bien dakord që GERMIN do të ndihmojë personelin e Ministrit të Shtetit për Diasporën, me këshilla teknike dhe shërbime të tjera me marrëveshje ndërmjet palëve;
3. Të dyja palët duhet të bashkëpunojnë dhe të angazhohen për të siguruar bashkëpunimin dhe financimin nga palët e treta (d.m.th. nga donatorë ndërkombëtarë dhe kombëtarë, si: IOM, GIZ, SDC etj.);
4. Palët do të japin hapësirë në faqet informuese (ueb faqet dhe rrjetet sociale), të tyre për programet e përbashkëta.

### **Neni 5**

#### **Fushat e Bashkëpunimit**

Palët bien dakord se do të bashkëpunojnë në fushat e mëposhtme me interes të përbashkët:

1. Regjistrimi i Diasporës: Palët bien dakord që të punojnë së bashku në zhvillimin e një programi të përbashkët për të lehtësuar procesin e regjistrimit të Rrjetit të Profesionistëve Shqiptarë në Diasporë. Baza e të dhënave aktuale, e cila do të zhvillohet, do të përfshinte individët, bizneset dhe inkorporimin e databazës ekzistuese të organizatave joqeveritare. Çdo platformë online do të zhvillohet me transparencë dhe shkëmbim të plotë informacioni, i cili do të reflektojë edhe shqetësimet e privatësisë që duhet të merren parasysh;
2. Konferenca për Diasporën: Palët bien dakord që të sigurojnë bashkëfinancim për konferencën, e cila do të mbledh pjesëtarët nga komuniteti i Diasporës, grupet e interesit, bizneset dhe profesionistët, për të zhvilluar bashkërisht një qasje të bashkërenduar më mirë me institucionet publike të Shqipërisë



dhe Kosovës, si mundësi për të forcuar më tej kuadrin ligjor dhe angazhimin me komunitetet e diasporës;

3. Samiti i Diasporës: Palët do të punojnë në projektimin, planifikimin dhe organizimin e Samitit të Diasporës me qëllim që procesi të jetë sa më gjithëpërfshirës.

4. Shkolla e Diasporës në Shqipëri: Palët do të koordinojnë vlerësimet në planifikimin, mbledhjen e fondeve, implementimin dhe zhvillimin e aktiviteteve në terren për Shkollën e parë të Diasporës në Shqipëri.

5. Këshilli i Diasporës: Palët do të bashkërendojnë përpjekjet për të formuar një Këshill Shqiptar të Diasporës. Këshilli do të bazohet në praktika të ngjashme të vendeve të tjera, duke ju referuar termave specifike, si dhe dispozitave të qarta dhe transparente.

6. Programet e tjera: Palët do të bashkëpunojnë në hartimin dhe zbatimin e programeve të përbashkëta siç referohen në nenin 2, pika 2.

### **Neni 6**

1. Mosmarrëveshjet, do të zgjidhen me mirëkuptim midis palëve nëpërmjet konsultimeve periodike.
2. Palët kanë të drejtë të ndryshojnë këtë memorandum pas konsultimeve dhe marrëveshjeve midis palëve.

### **Neni 7**

Secila palë ka të drejtë të shkëpusë këtë marrëveshje, në çdo kohë, pas konsultimit paraprak të përbashkët dhe përmes një njoftimi zyrtar me shkrim.

**MINISTRI I SHTETIT PER DIASPOREN**

**DREJTORESHE E PROGRAMEVE  
ORGANIZATA GERMIN**

**PANDELI MAJKO**

**LIZA GASHI**